REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGIM ROBO
NOTER
TIRANË

# KONTRATE-SHITJE
# KUOTASH TE SHOQERISE

Midis,

SHITESVE : Z. Alberto Marras, qytetar italian, lindur ne Rome, me 08.02.1938, banues ne Rome, me n. pashaporte 300104 R dhe Zj. Etleva Ilo Bllaci, me nenshtetesi shqiptare, lindur ne Tropoje, me 20 - qershor 1970, banuese ne Sarande, me n. pashaporte 0370137, ortake ne shoqerine "ERA" sh.p.k., e regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranes, me nr. vendimi 16173, date 24.10.1996, me seli ne Tirane, Rruga "Mihal Duri", n. 16,

dhe

BLERESVE : Z. Jonian Luan Mato, me nenshtetesi shqiptare, lindur ne Sarande, me 27 - shtator 1971, banues ne Sarande, Lagja 4, me n. pashaporte 0406371 dhe Z. Shkelqim Alush Mane, me nenshtetesi shqiptare, lindur ne Sarande, me 25.04.1970, banues ne Sarande, Lagja 3, Rruga Adem Sheme,

lidhet kjo kontrate shitje, me kushtet e meposhtme :

Shitesit jane bashkeortake te shoqerise "ERA" sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranes, me kapital themeltar 100.000 leke, qe zoterojne respektivisht z. Marras 51 % dhe zj. Bllaci 49 % te kapitalit. dhe i transferojne bleresve, z. Jonian Mato dhe Shkelqim Mane te gjitha kuotat qe zoterojne ne shoqerine e siperpermendur. Bleresit i blejne kuotat ne menyre te barabarte, pra sejcili blen gjysmen e kuotave te afruara.

Vlera e kuotave eshte edhe çmimi i shitjes se tyre.

Shitesit garantojne bleresit qe kuotat, objekt i kesaj kontrate, jane plotesisht te disponueshme, te trasferueshme dhe te lira nga çdo lloj pengu, ipoteke apo barre tjeter ligjore.

Lidhur per sa me siper, shitesit jane dakort dhe me firmosjen e kesaj kontrate zoterinjte Jonjan Mato dhe Shkelqim Mane behen bashkeortake me te drejta te barabarta (sejcili nga 50 % te kapitalit) te shoqerise "ERA" sh.p.k.

Kjo kontrate redaktohet ne kater kopje origjinale.

SHITESIT
Alberto Marras

Etleva Bllaci

BLERESIT
Jonjan Mato

Shkelqim Mane